KËSHILLI I QARKUT VLORË

Nr 1771 Prot

Vlorë, më 06.07.2026

VENDIM
Nr. 08, datë 29.06.2026

PËR
ZBATIMIN E MARRËVESHJES SË POSAÇME NDËRMJET KËSHILLIT TË QARKUT VLORË DHE AVOKATURËS SË PËRGJITHSHME TË SHTETIT "PËR DHËNIEN E ASISTENCËS JURIDIKE PËR PËRGATITJEN/NËNSHKRIMIN, DEPOZITIMIN E REKURSIT DHE PËRFAQËSIMIN LIGJOR NË GJYKATËN E LARTË"

Këshilli i Qarkut Vlorë, në mbledhjen e datës 29.06.2026, mbështetur në Ligjin Nr. 139, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, Ligjin Nr. 7850, datë 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjin Nr. 8116, datë 29.03.1996 "Kodi i Procedurës Civile", neni 96/a dhe neni 474, i ndryshuar, Ligjin Nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjin Nr. 10018/2008 "Për Avokaturën e Shtetit" i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 711, datë 20.11.2024 "Për Miratimin e Rregullores "Për Marrëdhëniet e Avokaturës së Shtetit dhe Personave Juridike në kuadër të ofrimit të asistencës juridike, rolin e Avokatëve të Shtetit në gjykim si dhe normat e posaçme procedurale" i ndryshuar si dhe marrëveshjes së posaçme nënshkruar midis palëve, protokolluar me tonën Nr. 1550 Prot, datë 10.06.2026,

VENDOSI:

1. Zbatimin e marrëveshjes së posaçme ndërmjet Këshillit të Qarkut Vlorë dhe Avokaturës së Përgjithshme të Shtetit "Për dhënien e asistencës juridike për përgatitjen/nënshkrimin, depozitimin e rekursit dhe përfaqësimin ligjor në Gjykatën e Lartë".
2. Ngarkohet për zbatimin e marrëveshjes së posaçme ndërmjet Këshillit të Qarkut Vlorë dhe Avokaturës së Përgjithshme të Shtetit, Kryetari i Këshillit të Qarkut Vlorë dhe Drejtoria e Financës, Zhvillimit Ekonomik dhe Social.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 78, pika 3 e Ligjit Nr. 139/2015 dt.17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar.

KRYETAR
Ervis Mocka

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - KËSHILLI I QARKUT VLORË

Drejtore e Drejtorisë së Financës, Zhvillimit Ekonomik dhe Social
Anisa Hyseni

Specialiste/Juriste
Alma Myrtaj

Specialist
Palush Naçi

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Pallati i Kulturës "Labëria" , Vlorë
Vlorë (AL)

Web site: www.qarkuvlore.gov.al
E-mail:info@qarkuvlore.gov.al
Tel: +355 33 421 600

KËSHILLI I QARKUT VLORË

RELACION

PËR
ZBATIMIN E MARRËVESHJES SË POSAÇME NDËRMJET KËSHILLIT TË QARKUT VLORË DHE AVOKATURËS SË PËRGJITHSHME TË SHTETIT "PËR DHËNIEN E ASISTENCËS JURIDIKE PËR PËRGATITJEN/NËNSHKRIMIN, DEPOZITIMIN E REKURSIT DHE PËRFAQËSIMIN LIGJOR NË GJYKATËN E LARTË"

Të nderuar Këshilltarë,

Mbështetur në Ligjin Nr. 139, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, Ligjin Nr. 7850, datë 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjin Nr. 8116, datë 29.03.1996 "Kodi i Procedurës Civile", neni 96/a dhe neni 474, i ndryshuar, Ligjin Nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjin Nr. 10018/2008 "Për Avokaturën e Shtetit" i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 711, datë 20.11.2024 "Për Miratimin e Rregullores "Për Marrëdhëniet e Avokaturës së Shtetit dhe Personave Juridike në kuadër të ofrimit të asistencës juridike, rolin e Avokatëve të Shtetit në gjykim si dhe normat e posaçme procedurale" i ndryshuar, institucioni i Këshillit të Qarkut Vlorë ka kryer korrespondencë me Avokaturën e Përgjithshme të Shtetit me qëllim përmbushjen e detyrimeve ligjore në rastet kur duhet të ndjekë procedura ligjore pranë Gjykatës së Lartë, procedura që duhet të ndiqen detyrimisht vetëm nga avokat ose Avokatura e Shtetit.

Pas kryerjes së korrespondencës, dy institucionet shprehën vullnetin dhe dakortësuan për nënshkrimin e "Marrëveshjes së posaçme", protokolluar me tonën Nr. 1550 Prot, datë 10.06.2026, sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuara në këtë marrëveshje, ku Avokatura e Shtetit do të ofrojë asistencë juridike për Këshillin e Qarkut Vlorë në përgatitjen/ nënshkrimin, depozitimin e rekursit dhe përfaqësimin ligjor në Gjykatën e Lartë, për çdo çështje gjyqësore, për të cilën Këshilli i Qarkut Vlorë shpreh vullnetin nëpërmjet autorizimit me shkrim për përfaqësim në mbrojtje të interesave të institucionit të Këshillit të Qarkut Vlorë e udhëhequr nga parimet e profesionalizmit, të efiçencës, të konfidencialitetit, të unitetit të doktrinës, të përgjegjësisë dhe korrektësisë në zbatimin e të gjithë normave procedurale të parashikuara në Ligjin Nr. 10018/2008, "Për Avokaturën e Shtetit", i ndryshuar.

Për sa më sipër kërkojë miratimin tuaj për zbatimin e Marrëveshjes së Posaçme ndërmjet Këshillit të Qarkut Vlorë dhe Avokaturës së Përgjithshme të Shtetit.

Ju faleminderit!

Grupi i punës
Drejtore e Drejtorisë së Financës, Zhvillimit Ekonomik dhe Social
Anisa Hyseni
Specialiste/Juriste
Alma Myrtaj
Specialist
Palush Naçi

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Pallati i Kulturës "Labëria" , Vlorë
Vlorë (AL)

Web site: www.qarkuvlore.gov.al
E-mail:info@qarkuvlore.gov.al
Tel: +355 33 421 600